

TURIZMI I ERRËT: PIRAMIDA SI ATRAKSION TURISTIK

Abstrakt

Ky punim synon të ofrojë një vështrim të përgjithshëm në fushën e “turizmit të errët” si një lloj turizmi me interes të veçantë. Punimi është i organizuar në dy pjesë, ku në pjesën e parë do bëhet një rishikim i literaturës së lidhur me turizmin e errët si dhe karakteristikat kryesore të këtij turizmi, duke paraqitur tipologjinë e destinacioneve të errëta, sipas Stone-t, duke u përqendruar në pyetjet: Çfarë quajmë turizëm të errët? Cilat janë destinacionet kryesore që bëjnë pjesë në këtë turizëm? A mund ta konsiderojmë atë pjesë të trashëgimisë kulturore? Në pjesën e dytë, duke u bazuar në tipologjitë e vendeve të errëta dhe në grupet kryesore që krijojnë hapësirën e këtyre vendeve, do të fokusohemi në rastin e muzeut “Enver Hoxha”, i njohur ndryshe si Piramida, për të parë nëse ajo mund të konsiderohet atraksion i të ashtuquajturit turizëm i errët. Në këtë pjesë janë analizuar disa intervista për të kuptuar më mirë informacionin që kanë turistët për këtë lloj turizmi si dhe arsytet se pse turistët i vizitojnë këto vende.

Fjalë kyçe: komunizmi, trashëgimia, turizmi i errët, turistët, Piramida

Abstract

This article aims to give a framework of one of the most interesting types of tourism, that of "dark tourism". The article is structured into two sections, the first one covers some literature related to "dark tourism" and its main characteristics, having in consideration the typology of dark destinations according to Stone. The main questions include: What is "dark tourism" and which are the main destinations part of this tourism? Is this considered part of

cultural heritage? Focusing in the typology of "dark sites" and the main groups that create this places, the Mausoleum of Enver Hoxha, known as Piramida (Pyramid) is taken as a case study in the second part of the article. May it be considered an attraction of "dark tourism"? Some interviews are analyzed in this part in order to understand the information tourists have and the reasons why tourists visit this place.

Keywords: communism, heritage, dark tourism, tourists, Piramida (Pyramid)

Hyrje

Për një periudhë 45-vjeçare (nga viti 1944 deri më 1990), Shqipëria kishte një regjim politik komunist që shënoi historinë e vendit. Hartimi memorial i kësaj periudhe ndahet në dy faza: faza e shkatërrimit, që kishte interes zhdukjen e gjurmëve të dukshme të asaj që ishte vendosur në vende të ndryshme gjatë periudhave të mëparshme dhe faza e rindërtimit, që kishte për qëllim ngritjen e monumenteve dhe muzeve, të cilat do të përdorëshin si strategji për të përhapur ideologjinë marksiste-leniniste dhe për të përforcuar kultin e personalitetit të Enver Hoxhës. Emrat e rrugëve, bulevardeve dhe shesheve në çdo vend ishin të lidhura me komunizmin. Qëllimi kryesor i kësaj strategjie ishte t'i bënin ato të pavdekshëm dhe të përjetshëm në kujtesën individuale dhe kolektive të shqiptarëve dhe shoqërisë shqiptare. Kjo është e dukshme nga numri i monumenteve të ngritur gjatë regjimit komunist, i cili rezulton në 700 dhe numri i muzeve të ngritur gjatë kësaj periudhe deri në 1989 (Adhami 2001, 38).

Me rënien e komunizmit vendi pësoi ndryshime edhe në qëndrimin ndaj monumenteve dhe arkitekturës së tyre. Në këtë periudhë u përdorën mënyra të ndryshme për ndërtimin e identitetit të ri kombëtar. Shumë nga monumentet që kujtonin regjimin u hoqën, u zhvendosën, u transformuan duke e bërë origjinën e tyre të paqartë. (Kjo u realizua duke hequr kujtesën më të dukshme të origjinës së ndërtesës si, p.sh., yllin e kuq, i cili pothuajse nuk mungonte në çdo rast. Të tjera thjesht u injoruan si fizikisht, ashtu dhe shoqërisht). Një ndër këto monumente është ai i njohur si Piramida, e cila i rezistoi kohës, duke qenë gjithmonë pjesë e debateve për funksionin e saj të ri. Gjatë periudhës së komunizmit ajo funksionoi si muze për diktatorin Enver Hoxha, rol të cilin e mbajti vetëm për dy vjet (1988-1990). Pas kësaj periudhe,

Piramida ndryshoi disa herë destinacionin. Instituti i Monumenteve të Kulturës e shpalli monument kulture të kategorisë së dytë, me urdhrin nr. 276, të ministrit të kulturës, më datë 16 korrik 2015.¹

Synimi i këtij punimi është të njihemi me literaturën mbi turizmin e errët, si një lloj turizmi me interes të veçantë dhe duke u bazuar në tipologjitë e vendeve të errëta apo në grupet kryesore që krijojnë hapësirën e këtyre vendeve, të shohim nëse muzeu i diktatorit Enver Hoxha (i cili do merret si rast studimi), i njohur ndryshe si Piramida, mund të konsiderohet atraksion i të ashtuquajturit turizëm i errët. Për të arritur këtë, janë përdorur intervista gjysmë të strukturuar si metodë kërkimi për të kuptuar arsyen që i çon turistët të vizitojnë këto vende. Këto intervista u kryen nga autori me turistë të rastit në agjencitë turistike në kryeqytet. Ishte shumë e rëndësishme të përfshiheshin në intervista edhe vetë guidat vendase, të cilat ndihmuan për t'u informuar më shumë rreth vizitave të këtyre vendeve.

Literatura mbi turizmin e errët

Ndërsa turizmi ka ekzistuar për më shumë se një shekull, trend në rritje i disa dekadave të fundit është popullariteti i një forme të veçantë të turizmit, në të cilën vizitorët kërkojnë përvoja autentike dhe njohuri për historinë e kulturës lokale. Ky ndryshim në sjelljen turistike është shfaqur rreth fundit të shekullit XX, veçanërisht tek turistët perëndimorë. Kjo çoi në rritjen e kërkesës ndaj këtij lloj turizmi, që ka qenë dhe fokusi i shumë studimeve akademike në dekadat e fundit të njohura si "turizmi i errët", një lloj i veçantë i turizmit që përfshin vendet e mizorisë dhe magjepsjen e turistëve me vdekjen dhe tragjedinë.

Termi "turizmi i errët" është përdorur për të parën herë nga studiuesit Malcolm Foley dhe John Lennon në 1996 për të përshkruar fenomenin, i cili përfshin prezantimin dhe konsumin (nga vizitorët) e vdekjes të lidhur me luftën, gjenocidin, vrasjet dhe ngjarje të tjera tragjike (Foley dhe Lennon 2000).²

¹ Instituti i Monumenteve të Kulturës "Gani Straizimiri": "Lista dhe harta e shpalljes Monumente Kulture të Kategorisë së dytë në Tiranë, konsultuar për herë të fundit 7 tetor 2018, <http://imk.gov.al/wp-content/uploads/2015/08/LISTA-DHE-HARTA-E-SHPALLJES-MON-KULTURE-KATII-OBJEKTET-E-TR.pdf>.

² Në vitin 1996, Malcolm Foley dhe John Lennon botuan "JFK and dark tourism: A fascination with assassination". *International Journal of Heritage Studies* 2 (4), 198-211.

Më vonë, autorë të tjerë e përsosën këtë përkufizim më tej, p.sh: turizmi i errët përfshin edhe vizita në fushëbeteja historike, varreza, dhe kampe përqendrimi, veçanërisht të vendeve të Holokaustit.

“Që kur njerëzit filluan të udhëtojnë, ato janë tërhequr drejt vendeve, atraksioneve ose ngjarjeve që janë disi të lidhura me ngjarje historike negative ku vdekja, dhuna, vuajtja apo fatkeqësia kanë luajtur një rol të madh” (Sharpley dhe Stone 2009, 114. Përkthimi im).

Sipas Stone-t, origjina e këtij fenomeni mund të gjurmohet që në lashtësi, kur njerëzit merrnin pjesë në arena për të dëshmuar luftën e gladiatorëve ose në ekzekutimet publike gjatë epokave mesjetare (Stone 2005). Kjo është dëshmi për turizmin e vdekjes, që daton shumë kohë para se një emër të vihej në dukje. Stone-i e përshkroi atë si "udhëtim në vendet e vdekjes dhe vuajtjes", thjesht duke qenë "një koncept i vjetër në një botë të re" (Stone 2005, 20).

Literatura është e mbushur me këtë formë të re të turizmit duke zbuluar, ndër të tjera, sinonime të termit si: "turizëm i errët", "thanatourism" (fjalë që vjen nga greqishtja e lashtë "thanatos", e cila nënkupton vdekjen, duke u lidhur me turizmin e errët, por duke raportuar veçanërisht për vdekjen e dhunshme), "turizëm i frikshëm", "turizmi i turbullt", "turizmi i tmerrshëm", "turizmi i turpit", "turizmi i hidhur", "turizmi i gjenocidit", "trashëgimia e errët", "trashëgimia e padëshiruar" etj. Tek Greg Ashworth dhe John Tunbridge (2000), vëmë re një definicion tjetër të këtij turizmi, si "turizmi horror", një vizitë e vendeve me vdekje masive. Një kamp përqendrimi mund të bëhet një destinacion për një udhëtim rekreativ dhe të promovohet si një atraksion turistik. Turistët ndërkombëtarë mund të jenë të përgatitur të konsumojnë "trashëgiminë e padëshiruar" të një kombi tjetër menjëherë, përpara se njerëzit e këtij kombi të jenë të gatshëm ta konsiderojnë këtë të kaluar si trashëgimi. Pra, te këta autorë, vëmë re një prirje drejt konsumimit të kësaj trashëgimie në mes të turistëve, duke çuar në lidhjen mes kujtesës kombëtare dhe ndërmarrjes kapitaliste të konsumit bazuar tek turizmi.

Në vitin 2000, ata rifilluan hulumtimin e tyre fillestar për turizmin në vendin e vrasjes së John F. Kennedy-t dhe e kombinuan atë me studime të rasteve shtesë në librin e tyre *Dark Tourism: The attraction of death and disaster*(2000), që ndihmoi në shpërndarjen dhe popullarizimin e konceptit të turizmit të errët më tutje.

Ndërsa format e mëparshme të turizmit arritën diferencimin përmes ikjes nga realiteti dhe relaksimit, turizmi postmodern arrin këtë qëllim përmes kulturave dhe traditave të kundërta. Autorë, si Frans Schouten (2005) ia atribuojnë këtë ndryshim globalizimit modern, turistët janë gjithnjë e më kuriozë për atë që e bën një komb të dallueshëm nga pjesa tjetër e botës. Kështu, duke iu përgjigjur nevojave në ndryshim të udhëtarëve, qytetet dhe destinacionet turistike përqendrohen në rritjen apo edhe ekzagjerimin e dallimeve të tyre kulturore e historike, duke i siguruar turistëve një përvojë të jashtëzakonshme. Duke pasur parasysh këtë ndryshim tek turistët, rajoni post-komunist është bërë një objekt kryesor për këta lloj turistësh.

Por a janë të gjitha vendet e turizmit të errët njësoj?

Stone-i shkruan në lidhje me tipologjinë e vendeve të turizmit të errët. Ai paraqet "shtatë furnizuesit e errët" me qëllim të ndërtimit të një kuadri konceptual, në të cilin mund të gjendet furnizimi i një produkti të turizmit të errët.

1) **Fabrikat e errëta të zbavitjes:** janë vendet e argëtimit, të cilat paraqesin vdekje reale ose imagjinare dhe ngjarjet makabre me etikë komerciale. Stone-i merr si shembull kryesor "Drakula Park" në Rumani. I vendosur në një kështjellë mesjetare, ky vend i kthyer në argëtim paraqet mitin e aristokratit Drakula si dhe paraqet formën më të lehtë të spektrit të errët.

2) **Ekspozitat e errëta:** ofrojnë produkte të lidhura me vdekjen, shpesh me një mesazh përkujtimor, edukativ dhe reflektues. Pavarësisht nga etika konservatore, këto vende përfshijnë një infrastrukturë të turizmit dhe një fokus tregtar. Ekspozitat e errëta, shpesh ndodhen larg vendndodhjes reale të vdekjes. Këto ekspozita tentojnë të provokojnë e jo të tregojnë. Për shembull, ekspozita botërore "Trupi i Botëve" ngjalli një bisedë etike rreth shfaqjes së kufomave të ruajtura përmes një teknike të quajtur *plastination* në emër të edukimit shëndetësor, anatomisë dhe fiziologjisë.³

³ Kjo është një ekspozitë udhëtimi i trupave të njeriut, kafshëve dhe strukturave të tjera anatomike të trupit që janë ruajtur përmes procesit të plastinimit. Gunther von Hagens-i zhvilloi procesin e ruajtjes në fund të viteve '70. Një seri ekspozitash

3) **Burgjet e errëta:** paraqesin dënimet e mëparshme të burgut dhe rivendosjen e sistemeve gjyqësore në histori përmes turizmit dhe ambienteve që presin vizitorët. Është sugjeruar që këto vende mund të zënë qendrën e spektrit, duke pasur elemente të errëta dhe të lehta. Për shembull, Galeria e Drejtësisë në Nottingham (Angli), e promovuar si "tërheqja familjare e vitit", është krijuar nga ndërtesat e përdorura fillimisht si burgje dhe gjykata. P.sh., Galeria e Drejtësisë fton vizitorin të marrë pjesë në një lloj të veçantë të trashëgimisë me një linjë marketingu të quajtur: "Të ndjesh frikën".

4) Ka edhe **varreza** si vende të destinacionit "të errët" të turizmit. Shoqata e varrezave të rëndësishme në Evropë (ASCE) thekson se varrezat mbeten një trashëgimi kulturore e rëndësishme. Njerëzit vizitojnë varrezat kryesisht për shkak të respektit dhe përkujtimin e të dashurve të humbur, por edhe për të studiuar historinë lokale.

5) **Shtresat e errëta:** shpesh ndodhen shumë afër vendndodhjes së vdekjes dhe brenda një periudhe të shkurtër kohore të vdekjes që po ndodh. Shumica e këtyre vendeve janë jo-qëllimshëm për turizmin dhe kanë shumë pak infrastrukturë turistike. Këto vende janë të përkohshme dhe kanë si funksion kujtimin dhe respektin për të vdekurit e kohëve të fundit. Media ka një rol të madh në paraqitjen e këtyre vendeve. Si shembull, Stone-i përmend portat e Pallatit Kensington, që u bënë pikë qendrore për miliona njerëz në kohën kur princesha e Wales-it, Diana, u aksidentua në vitin 1997. Brenda një periudhe relativisht të shkurtër, kjo faqe u çmontua dhe u rindërtua - me infrastrukturën e turizmit - në shtëpinë e Althorp-it.⁴

6) **Vendet e konflikteve të errëta:** janë historike, të lidhura me temën e luftës dhe, në fakt, nuk rekomandohen të vendosen në kontekst të turizmit "të errët". Këto vende në thelb kanë një fokus arsimor dhe përkujtimor, edhe pse faqet e errëta të konfliktit, shpesh kanë ideologji të forta politike në sfond. Për shkak të rritjes së udhëtimeve nga operatorët turistikë, këto fusha të betejës dhe

anatomike të "Trupit të Botëve" ka vizituar shumë vende në mbarë botën, duke ngritur ndonjëherë polemika rreth shfaqjes së kufomave dhe pjesëve trupore.

⁴ Althorp ka qënë shtëpia e familjes së princeshës Diana, për më shumë se 500-vjet. Aktualisht është shtëpia e vëllait të princeshës Diana dhe gjithashtu vendi ku ajo është varrosur.

atraksione të tjera të lidhura me luftën po bëhen gjithnjë e më komerciale. Ka dallime në mënyrat e shfaqjes së historisë midis vendeve të betejës, bazuar në distancën kronologjike. Ato beteja që janë përtej kujtesës së gjallë, shpesh marrin një orientim më romantik dhe, për këtë arsye, mund të klasifikohen si më të lehta në spektrin e turizmit të errët.

7) **Kampet e errëta të gjenocidit:** janë pjesa më e errët e spektrit të turizmit të errët. Këto vende përfaqësojnë vende që kanë gjenocid, mizori dhe katastrofa si temë kryesore thanatologjike. Kampet e errëta të gjenocidit ndodhen në vendin aktual të ngjarjes së vdekjes dhe kanë një shkallë të lartë të ideologjisë politike bashkangjitur me ta. Vende të tilla, si Auschwitz-Birkenau, i njohur si një simbol universal i së keqes, të cilat flasin për tregimet e tmerrshme të vuajtjeve njerëzore. (Stone 2006, 153-156)

Stone na kujton se shumë produkte të turizmit të errët janë shumë të shtresuara dhe grupet e njerëzve në pjesë të ndryshme të botës mund t'i perceptojnë ato produkte ndryshe. Ai paraqet një shënim nga A.V. Seaton-i (1999), i cili sugjeron që ndryshimet në mjedisin e errët, për shembull, manipulimi i "trashëgimisë së errët" për qëllime politike, ose duke shtuar elemente zbavitëse në ekspozitë të errët, mund të bëjnë furnizuesit të rrëshqasin përgjatë spektrit të turizmit të errët. Gjithashtu, shumë produkte mund të jenë një përzierje e karakteristikave të përshkruara dhe, për këtë arsye, të jetë e vështirë për t'u vendosur në një kornizë (Stone 2006, 159).

Bazuar në këtë spektër, shohim se vendet e turizmit të errët janë të ndryshme, përfshirë nga vende të fatkeqësive natyrore (p.sh., vizita në Napoli dhe Pompei), skena e sulmeve terroriste, varrezat dhe mauzole, monumentet për viktimat e luftës dhe mbrojtësit heroikë, fushat e betejës, burgjet (Alcatraz, Canon City Colorado) e deri tek fatkeqësitë bërthamore (Çernobil në Ukrainë, Fukushima në Japoni), duke krijuar kështu një tipologji të këtij turizmi me nënndarje të tilla, si: turizmi i varreve; turizmi i holokaustit; turizmi i gjenocidit; turizmi i burgut; turizmi i fushë-betejave; turizmi i komunizmit; turizmi i luftës së ftohtë; turizmi nuklear; turizmi i vendeve të vrasjeve; turizmi i fatkeqësive natyrore; turizmi terrorist; turizmi paranormal; turizmi i aksidenteve etj. Të gjitha këto vende edukojnë, sjellin kujtime, informojnë dhe përpiqen të apelojnë tek njerëzit dhe vendimet e tyre. Pavarësisht nëse efektet e fatkeqësive

janë rezultat i natyrës ose vendimeve historike socio-politike, të cilat shkaktojnë shumë fatkeqësi, të gjitha ndajnë dhimbjet, terrorin dhe vdekjen.⁵

Në rishikim të literaturës që shqyrtoam deri më tani, shohim dy aspekte të ndryshme të turizmit të errët. Këto aspekte janë elemente të ndarjes së territorit: vendet “primare”, ku janë vende që ka ndodhur një katastrofë, pra vendet aktuale të fatkeqësive dhe vendet “dytësore”, që përfshihen ndërtesat ose monumentet që janë ndërtuar në funksion të katastrofës që ka ndodhur. Në këtë pikë duhet theksuar se vendet e vërteta të vdekjes ose ekspozitat relevante rreth fatkeqësive janë elemente kyçe për turizmin e errët. Pra, turizmi i errët është një përzierje e historisë, trashëgimisë dhe tragjedi.

A është turizmi i errët pjesë e trashëgimisë?

Trashëgimia përbën copa të mëdha dhe unike të së kaluarës tonë, por koncepti i saj është zgjeruar me kalimin e kohës dhe madje mund të përfshijë edhe vendet e traumave. UNESCO-ja e ka përkujtuar trashëgiminë kulturore në projekt-planin afatmesëm 1990-1995:

"Trashëgimia kulturore i jep çdo vendi karakteristikat e tij të veçanta dhe është depo e përvojës njerëzore, duke përfshirë edhe vuajtjet, edhe dëshitimet, dhe ajo që i jep një vendi karakterin e tij"⁶.

⁵ Destinacionet kryesore të turizmit të errët konsiderohen muzetë, varrezat, lagjet e varfra, kampet e përqendrimit, skenarët e luftës, përpjekjet ose vende të tjera të tragjedisë. Për më shumë, rreth destinacioneve kryesore të këtij turizmi në botë shih: dark-tourism.com. (konsultuar për herë të fundit më 28 gusht 2018). Në këtë faqe do gjeni informacione rreth vendeve të ndryshme në botë që bëjnë pjesë në këtë turizëm, si Kampi i përqendrimit dhe shfarosjes në Auschwitz (Poloni) me deri në 1.400.000 vizitorë; Ground Zero, si përkujtim i 11 shtatorit në New York (ShBA) me përafërsisht 1.000.000 vizitorë; Hiroshima Peace Memorial Park (Japoni) me rreth 53.000.000 vizitorë; Bran Castle e Drakulas (Rumani) me mbi 500.000 vizitorë çdo vit; Pompei (Itali) me rreth 2.500.000 vizitorë në vit; Katakombet e Parisit (Francë) me rreth 300.000 vizitorë në vit; Shtëpia e Ana Frankut (Amsterdam) e cila në vitin 2015 arriti 31.056.300 vizitorë. Në këtë faqe gjejmë të listuar edhe Shqipërinë me tre destinacione kryesore për këtë turizëm.

⁶ UNESCO Projekt-plani afatmesëm 1990-1995: 25 C/4, konsultuar për herë të fundit më 20 shtator 2018, <http://whc.unesco.org>.

Për të përcaktuar trashëgiminë si një depo e përvojave tona, nuk do të thotë se ajo duhet të jetë diçka pozitive ose diçka që shumica dëshiron ta ruajë, ajo përfshin shumë atraksione të ndryshme, secila me rëndësi historike, që mund të shkojnë nga ndërtesat historike dhe monumentet, deri tek parqet natyrore dhe festivalet. Ky është një përkufizim i trashëgimisë, i cili është më i lehtë për t'u aplikuar për turizmin e errët. Trashëgimia kulturore sot përdoret, pra, si një koncept më i zgjeruar, duke bërë pjesë të saj edhe vendet e fatkeqësive. MacCannell-i sugjeron që turizmi i errët është një nënkategori e turizmit të trashëgimisë dhe se numri i vizitorëve në zonat e dikurshme të luftës, kampet e përqendrimit, varrezat dhe burgjet dëshmon për pretendimin e tij. Kjo tregon se thjesht prezenca e turistëve në një vend është bazë për klasifikimin e tij si trashëgimi.

Ai shpjegon se megjithëse jo të gjitha vendet e trashëgimisë kanë elemente të makabrit, mund të argumentohet se shumica e vendeve të caktuara si "të errëta" kanë elemente të trashëgimisë që lidhen me to, qofshin ato në nivelin personal, lokal ose global. Vendet e errëta, duke përfshirë fushat e betejës, varrezat, vendet ku vdiqën njerëzit e famshëm, burgjet dhe madje, edhe vendet e fatkeqësive natyrore, janë të gjitha në një farë mënyrë historike, sepse ato kujtohen si të tilla nga shoqëritë. Ato janë shenjuar si të denja për ruajtje, ashtu si vendet e trashëgimisë dhe si të tilla luajnë një rol në zhvillimin e qëndrimeve dhe vlerave shoqërore (MacCannell 1999).

Turizmi i errët në Shqipëri

Duke u bazuar në grupet dhe nëngrupet e turizmit të errët, edhe Shqipëria është një destinacion kyç në zhvillimin e këtij turizmi. Grupet kryesore që krijojnë hapësirën e këtyre vendeve në Shqipëri janë të ndryshme, që nga arkitektura, monumentet, ndërtesat institucionale, bunkerët, statujat dhe lapidarët, kampet e internimit, përmendoret e luftës, varrezat e lidhura me luftën apo fatkeqësitë, vendet e vdekjes, ritualet, besimet dhe ngjarjet.⁷ Megjithatë, nuk është synimi i këtij artikulli që të flasim për të gjithë

⁷ Në Shqipëri, turizmi është në rritje. Valorizimi i historisë së trazuar të vendit është i pranishëm në katalogët e turizmit. Ai mbështetet nga një politikë shtetërore që në mënyrë eksplicite përdor hartën e turizmit të trashëgimisë me qëllim të rindërtimit kombëtar dhe zhvillimit lokal përmes turizmit. Shërbimet në fjalë i korrespondojnë mirë turizmit të errët, edhe nëse vetë termi mbetet pak i përdorur.

destinacionet që mund të bëjnë pjesë në këtë turizëm. Në këtë pjesë do të fokusohemi në rastin e Piramidës (ish-muzeu “Enver Hoxha”), si një monument i trashëgimisë komuniste, i cili është edhe një nga destinacionet e referuar për Shqipërinë si turizëm i errët.⁸

Natyrisht, muzeu i diktatorit Enver Hoxha, nuk është një tërheqje e trashëgimisë konvencionale (Light 2000, 170), prandaj veçoria e tij mund të lidhet me pushimet me interes të veçantë, si turizmi i errët. Pas rënies së regjimit kjo ndërtesë është një ndër atraksionet turistike më të frekuentuara për vetë mënyrën e arkitekturës dhe një nga imazhet më të përdorura në materialet promovuese drejtuar turistëve ku rekomandohet, jo vetëm nga librat udhëzues në dispozicion,⁹ por edhe nga të gjitha faqet web që kanë si destinacion Shqipërinë. Për shembull, udhëzuesi i Lonely Planet (faqe web e promovimit të turizmit global) flet për atë si një "vendtakim për adoleshentët dhe turistët e tiranës apo si një kompleks memorial gjysmë i harruar."¹⁰

A është e mundur të interpretojmë Piramidën si atraksion i të ashtuquajturit turizëm i errët?

Varret, mauzole¹¹, muzetë e diktatorëve apo të periudhës komuniste bëjnë pjesë në atraksione të turizmit të errët, sipas Stone-i (2006:153-156).

⁸ Ne faqen www.dark-tourism.com Shqipëria ofron tre destinacione kryesore të turizmit të errët: piramida, muzeu historik kombëtar dhe bunkerët. Konsultuar për herë të fundit më 25 shtator 2018, <http://www.dark-tourism.com/index.php/albania-en>.

⁹ Guida e Tiranës, e cila shpërndahet nga zyra e informacionit (ngjitur me Teatrin e Metropolit) sugjeron për të gjithë turistët si atraksione kryesore: Piramidën; vilën e Enver Hoxhës; Muzeun e Diktaturës Bunk'Art, Shtëpinë e Gjetheve etj.

¹⁰ Faqet si: lonelyplanet.com, tripadvisor.com, thecrazytourist.com ofrojnë një listë të 10 vendeve më të frekuentuara në vendin që do vizitosh. Në Tiranë në këto 10 vende është edhe Piramida. (Konsultuara për herë të fundit në gusht 2018).

¹¹ Është e rëndësishme të theksohet që muzeun “Enver Hoxha” e gjejmë shpesh ta quajnë dhe “Mauzoleu i Enver Hoxhes, kjo për shkak se ishte menduar se brenda do vendosej dhe varri i diktatorit, gje që nuk u realizua. Mgjithatë, ky nuk është përdorimi i saj qëllimshëm apo emërtimi zyrtar. Sipas arkitektit Kolaneci, muzeu Enver Hoxha nuk kishte për qëllim për t'u bërë një mauzole. Shih për këtë komentet e tij në: “Piramida, varr i Enverit: Gënjeshtër, *Portali Shqipëria.com*, konsultuar për herë të fundit

Turistët i vizitojnë këto vende për arsye të ndryshme, por Walter pretendon se në raste të tilla, njerëzit janë më të interesuar për jetën, sesa vdekjen e një personi të varrosur (Walter 2009, 53). Kjo është e dukshme edhe me Piramidën, pasi turistët e vizitojnë atë kryesisht, sepse janë të intriguar nga historia e kësaj ndërtese, gjithashtu nga jeta dhe puna e Enver Hoxhës, diktatorit të Shqipërisë. Megjithatë, koha mund të bëjë që monumenti të kalojë përmes spektrave të errët, sipas Stone-t (2006: 156) Duke ju referuar kësaj, Piramida në kohën e hapjes së saj më 1988, u vizitua nga shumë turistë të huaj dhe shqiptarë duke qenë në këtë mënyrë atraksion i denjë i turizmit të errët. Pas kthimit të saj në “qendër kulturore”, turizmi i errët zbehet, pasi roli i tij fillestar nuk është më deri në momentin që monumenti rikthehet në debatin për rifunksionalizimin e saj, duke e theksuar edhe njëherë si trashëgimi të periudhës komuniste dhe duke e kaluar edhe njëherë në një destinacion të errët për turistët e huaj.

Histori e Piramidës

Piramida është ngritur si një muze për diktatorin Enver Hoxha pas vdekjes së tij në vitin 1988. Ajo u ndërtua në dy vjet (1986-1988) dhe u inaugurua me rastin e 80-vjetorit të lindjes së tij. Projekti ju besua arkitektit të njohur Klement Kolaneci, i cili ngriti një grup projektimi ku merrnin pjesë Pranvera Hoxha, Pirro Vaso dhe Vladimir Bregu.¹² Ata zgjodhën vendin dhe modelin e një piramide (edhe se forma e saj nuk ishte forma e një piramide reale), si modelin më të përshtatshëm për funksionin e një muzeu. Ajo u vendos në qendër të kryeqytetit me një stil unik arkitektonik në krahasim me ndërtesat e tjera të ndërtuara gjatë periudhës komuniste.¹³

më 26 tetor 2018 <https://www.shqiperia.com/PIRAMIDA -varr-i-Enverit-Genjeshter!.9063>.

¹² Sokrat Mosko. “Arritje kulmore e arkitekturës sonë. Në muzeun Enver Hoxha”. *Drita*, 20 nëntor 1988, 4-13

¹³ Për më shumë rreth ndërtimit të Piramidës shih: AQSh i RSh, Fondi: 490, Viti: 1986, Dosja: 715.



Fig. 1. Piramida në vitet 1988-1990¹⁴

Sipas arkitekt Kolanecit: “

Zgjedhja e piramidës lidhet me tri motive, duke nisur që nga antikiteti i historisë së kombit tonë me varret, megjithëse këtu ishte e qartë se nuk do të kishte varr. Nëse e vështron piramidën, sidomos nga lart, ajo është bërë e tillë që ajo të shkojë në harmoni me formën e malit të Dajtit. Në të njëjtën kohë ajo, u ndërtua si një godinë jo me funksion të ngushtë, por si guaskë e hapur nga brenda. Ideja ishte e krijimit të një hapësire të vazhdueshme komunikuese me të gjithë ambientin.¹⁵

Ai tregon për idenë e ndërtimit të kësaj forme:

Këshilltarët më të mirë ishin fëmijët. Ishin ata që dhanë idenë fillestare të projektimit, me yjet e tyre. Na ngacmoi

¹⁴ Foto tërhequr nga: <https://albanianpyramids.wordpress.com/2012/01/21/enver-hoxhas-pyramid/>, gusht 2018

¹⁵ Petrika Grosi. “Kolaneci: Si e ndërtuam piramidën për Enverin”, *Albania*, n. 16, 22 janar 2008, 19

fantazia e tyre dhe zgjodhëm yllin. E morëm këtë simbol e ngritëm lart, por pa u shkëputur nga toka. Duhej që ai të lidhej organikisht me tokën. Për këtë na erdhi në ndihmë simboli ynë i kombit, shqiponja. Krahët e saj lidhen me yllin.¹⁶

Pas përfundimit të shpejtë të tij, ky muze u hap për vizitorët më 1988. Aty pasqyrohej jeta, lufta dhe puna e diktatorit, duke u kthyer në një simbol të veçantë, të papërdorur ndonjëherë, por, në të njëjtën kohë, sa më të komunikueshëm për mjedisin përreth, me peizazhin e veçanërisht me njerëzit. Ai u bë qendra simbolike e sheshit të kryeqytetit duke reflektuar rëndësinë e diktatorit në histori, pra, ai nuk ishte më thjesht një muze ku shfaqeshin objektet personale të diktatorit, por ishte një monument i epokës së tij, duke e bërë atë një vend të kujtesës kolektive.



Fig.2 Monumenti në mermer të bardhë i vendosur në qëndër të muzeut¹⁷

Monumenti në mermer të bardhë i udhëheqësit, i cili ishte vendosur në mes të muzeut, me qëllim që të shihej nga çdo pikë e tij, ishte shumë më tepër

¹⁶ Halil Lalaj dhe Besnik Musafaj. “Monument për Enverin, Monument për Shqipërinë”, *Zëri i popullit* 1988, 15 tetor, 1,3.

¹⁷ Foto tërhequr nga:

https://albanianpyramids.files.wordpress.com/2012/01/enver_hoxha_museum_6.jpg, konsultuar për herë të fundit më 13 tetor 2018

se dëshmi e së kaluarës, ishte një dëshmi simbolike e një të ardhmeje të ndërtuar mbi të tashmen. Prania e gjithë historisë së komunizmit në muze ishte specifika më e rëndësishme e muzeut si një vend i kujtesës së institucionalizuar. Gjithashtu, u ekspozuan edhe sendet personale të Enverit, si: veshje, këpucë, foto, armë, libra, aparate, makina e tij e parë, madje u imitua edhe dhoma ku kishte lindur:

“Në hollin e Piramidës ishte një skulpturë mjeshtërore e skulptorit të madh Kristaq Rama, ndërsa në seksionet e muzeut kishte me qindra sende personale që ishin përdorur nga Enver Hoxha, madje edhe një "Fiat" i viteve '30 që ishte përdorur nga Hoxha gjatë kohës së ilegalitetit, dhe që ishte përdorur edhe në disa filma të realizuar nga Kinostudio "Shqipëria e re".¹⁸

Me mbylljen e muzeut, objektet e përdorura për ekspozitat kaluan si pronë e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS). Lista përmban rreth 616 kartela me sende të ndryshme në një ose më shumë kopje. Aty gjenden:

“që nga karriget e kashtës, tavolinat e gdhendura në dru apo të lara në ar, me kokë luani apo me motive floreale, deri te bisturitë, orat e shtrenjta të dorës, portofolet, ditare, xhamadanë tropoje, kostume ushtarake, pallto e çizme me gëzof, qeleshe, pardesy, orë xhepi me qostek, radio dore me tranzistor, diktofonë, kalendarë elektronikë. Për të veçuar këtu një tjetër kategori si orët firmato "Seiko", stilolapsat e pafund të markave më në zë të kohës "Pelikan", "Aurora", etj., të dhuruara nga personalitete të ndryshme për Hoxhën, deri tek takëmet e argjendit, e bronzit dhe punimet e shumta të artistikeve, apo vepra autoriale të artistëve të njohur shqiptarë. Më tej lista vazhdon me emërtimet e tjera të objekteve të sekuestruara të Enver Hoxhës dhe numrin e tyre si hyrje në magazinë ku mund të përmendim dylbi të vogla për teatër, pipa druri të llojeve të ndryshme, me këllëfe e pa këllëfe, më gdhendje apo të thjeshta, deri te gjërat më të thjeshta si mbajtëset e cigareve, filtrat, kutitë e shkrepsëve e çakmakët, blloqet e shënimeve në lëkurë, kartvizitat, etj. Ndër librat, më interesante janë një

¹⁸ Vito Koci. “Një shtëpi e dashur, si një shkollë gjithnjë e hapur.” *Drita*, 16 tetor 1988, 3-4

sërë autorësh francezë, botime të viteve 1902-1927, por edhe botime të tjera në gjuhën arabe, angleze, etj. Më tej inventari i pasurisë së sekuestruar të Enver Hoxhës vijon mes të tjerash me kuti të ndryshme metalike, apo të lara në ar e argjend, nga vendi, Kina, Rusia, si dhe dhurata të tjera të kësaj natyre.”¹⁹

Megjithëse ky muze u ngrit për nder të diktatorit, Piramida nuk ishte asnjëherë muze i mirëfilltë. Ajo shërbeu për atë qëllim vetëm për dy vjet. Pas vitit 1990, muzeu mori emrin Piramidë gjatë lëvizjes studentore të dhjetorit 1990 për vetë formën gjeometrike që ajo kishte. Klement Kolaneci, një nga arkitektët tregon se:

“Nga ne si projektues të Godinës, nuk u mendua ndërtimi i një piramide. Godina mori emrin Piramida nga shumica e njerëzve kështu që mendimi i shumicës merret në konsideratë, por në fakt godina duket e tillë vetëm nëse je poshtë saj. Nëse e sheh piramidën në pamje ballore ajo ngjason me krahët e shqiponjës, s’ka lidhje me emërtimin e marrë. Megjithatë, dihet se një ndërtesë merr pamje të ndryshme, në vartësi nga këndi i vështrimit; dhe kështu të duket edhe si piramidë edhe si shqiponjë”.²⁰

Ndryshimet politike

Me rënien e regjimit komunist, një numër i madh ndërtesash u braktisën, pa ndonjë propozim për një funksionalitet të ri. Shumë të tjera u ripërvetësuan dhe u përdorën për funksione të tjera. Shpjegimi për këtë mund të gjendet, jo vetëm në mënyrën se si shoqëria i perceptoi ato, por edhe në mungesën e një mënyrë të arsyeshme për t’i përdorur ato. Shembull tipik është rasti i Piramidës. Kjo ndërtesë e humbi funksionin e saj si monument i periudhës komuniste, duke shënuar një ndryshim destinacioni për ndërtesën.

¹⁹ Petrika Grosi. “Pasuria e sekuestruar e Enver Hoxhës, publikohen inventarët”, 4 tetor 2008, konsultuar për herë të fundit më 7 tetor 2018, <http://www.arkivalajmeve.com/Pasuria-e-sekuestruar-e-Enver-Hoxhes-publikohen-inventaret.95214/>.

²⁰ Petrika Grosi. “Kolaneci. Si e ndërtuam piramidën për Enverin”, *Albania*, n. 16, 22 janar 2008, 9 (për më shumë rreth ndërtimit të Piramidës shih: AQSh i RSh, Fondi: 490, Viti: 1986, Dosja: 715).

Ngjarja e parë e organizuar ishte panairi i parë tregtar dhe, që atëherë, Piramida është përdorur për qëllime të ndryshme, duke qenë një vend i rëndësishëm në jetën kulturore dhe ekonomike të Shqipërisë. Konkretisht, ajo shërbeu edhe si një qendër kulture, për zyra dhe si një klub nate. Në fillim të viteve 2000, kjo ndërtesë u shpall monument kulture dhe në atë godinë u vendos televizioni Top-Channel. Në katin përdhes të saj u ndërtua një nga lokalet e natës më të njohura në Tiranë, i quajtur “Mumja”. Në 2005, u hodh ideja e kthimit të saj në bibliotekë kombëtare, gjë që nuk u realizua dhe në 2006, u quajt Qendra Kombëtare e Kulturës “Pjetër Arbërori”. Në sallat e kësaj qendre kryheshin aktivitete të ndryshme, si “Rinfest” dhe panairë të ndryshme, duke fshirë në këtë mënyrë çdo shenjë të muzeut “Enver Hoxha”. Kjo ishte një alternativë që u përdor edhe në vendet e tjera me të kaluar të vështirë, duke e bërë origjinën fillestare të paqartë: “Një mënyrë për të larguar aftësinë për të komunikuar atë që monumentet ishin ndërtuar për të komunikuar” (Macdonald 2009, 36).²¹

Megjithatë, Piramida vazhdoi të ishte pjesë e diskutimeve të vazhdueshme për ri-funksionalizimin e saj. Me ardhjen në pushtet të Partisë Demokratike, u shpall se atje do të ndërtohej Teatri i Ri, por që më parë kjo godinë duhej të rikonstruktohej, kështu që u hoqën të gjitha pllakat e mermerit me të cilat qe veshur.

Më pas, në vitin 2010, u vendos që Piramida të prishej dhe të kthehej në parlament. Ky vendim ngjalli një reagim të gjerë publik, disa ishin pro qeverisë dhe argumenteve të saj, ndërkohë që disa të tjerë ishin kundër. Por, kjo nuk ishte një praktikë e re në ndërtimin e identitetit në Europën Qendrore, ku në shumë raste monumentet dhe hapësirat publike janë rimodeluar, zhvendosur apo shkatërruar.²²

²¹ Studiuesja Sharon Macdonald e fokusuar në rastin e Nuremberg-ut (një qytet, emri i të cilit është i lidhur me nazizmin) angazhohet në një reflektim krahasues mbi zhvillimet në vende të tjera për të kontekstualizuar atë që po ndodhte në Nuremberg dhe për të treguar ngjashmëri dhe dallime nga mënyrat në të cilat "trashëgimet e tjera të vështira" janë trajtuar diku tjetër. Kështu, autorja ofron një perspektivë informuese mbi mënyrat e trajtimit të trashëgimisë së vështirë.

²² Rimodelimi, zhvendosja apo shkatërrimi i monumenteve të periudhës komuniste është një çështje e rëndësishme në gjithë Europën Qendrore pas viteve 1989 (shih: Verdery 1999).

Një nga argumentet kryesore të qeverisë së atëhershme për prishjen e Piramidës ishte shkatërrimi i simbolikës së diktaturës me argumentin se: "Nuk mund të ketë Piramidë në qendër të Tiranës që e bën kujtimin e një prej diktaturave më të këqija në Evropë fiksuar përgjithmonë në mendjet tona"²³.

Në mbështetje të këtyre argumenteve mjaft qytetarë kërkuan zhdukjen e këtij objekti, që u ngrit për nder të diktatorit Hoxha. Një monument, një bunker, të cilin ata nuk donin ta shihnin më, pasi u kujtonte vuajtjet e regjimit. Këtë kategori kundërshtarësh në të shumtën e rasteve e përbënte gjenerata e tretë, e cila e lidhte Piramidën me qëllimin fillestar të ndërtimit të saj. Një mendim i tillë u kundërshtua me forcë nga një grup intelektualësh shqiptarë të cilët hartuan një peticion, i cili u firmos nga rreth 6000 firma (Klosi dhe Lame 2011) dhe kjo u miratua edhe nga opozita.

Shkatërrimi i saj u përball edhe me kundërpërgjigjen e arkitektëve dhe të shumë qytetarëve të Tiranës, me sloganin "Mbani Enverin, na lini Piramidën"²⁴ me argumentet se: "ndërtesa është një shembull i mirë se si ideologjia është shprehur në arkitekturë dhe ilustron një periudhë të rëndësishme në historinë e kombit".²⁵ Në lidhje me këtë argument lind pyetja: a është Piramida realisht një muze i diktatorit?

Studiuesja Sharon Macdonald shkruan rreth "sipërmarrjes përkujtimore" (2009, 3), njerëz që përpiqen të nxisin kujtesën publike, për arsye se kanë qenë viktimë ose sepse ndjejnë një detyrim moral për të theksuar kujtimet e së kaluarës së afërt të vështirë, ndoshta me qëllim për të parandaluar historinë të ripërsëritet.²⁶ Ajo pyet në studimin e saj "Difficult Heritage", nëse identiteti i

²³ "Piramida në Tiranë, debatet e politikës dhe vendimi për ta transformuar atë", *Bota Sot*, 2 janar 2017, konsultuar për herë të fundit shtator 2018, <http://www.botasot.info/tirana-shqiperia/632925/piramida-ne-tirane-debatet-e-politikes-dhe-vendimi-per-ta-transformuar-ate/>.

²⁴ "Qindra qytetarë firmosin peticionin. Të rinjtë: Mbani Enverin, na lini Piramidën", *Tema*, 21 korrik 2011, konsultuar për herë të fundit 30 shtator 2018, <http://www.gazetatema.net/2011/07/21/qindra-qytetare-firmosin-peticionin-te-rinjte-mbani-enverin-na-lini-piramiden/>

²⁵ Qytetar nga Tirana, moshë 35, intervistuar nga autori në vitin 2011

²⁶ Sipas studiueses Macdonald, ky term u përdor për herë të parë nga Jordan, Jennifer A. 2006 në *Structures of Memory*. Understanding Urban Change in Berlin and Beyond, Stanford: Stanford University Press.

një ideologjie, e cila është materializuar, mund të ndryshojë nëse trashëgimia fizike mbetet e njëjtë? A ruhet domosdoshmërisht identiteti dhe koncepti, nëse trashëgimia fizike është ruajtur? Si në rastin e Piramidës, që nuk është më një muze i diktatorit, por ka pasur funksione të tjera që kanë ndikuar në jetën kulturore të Tiranës. Ndërkohë, ajo mund të shihet thjesht si arkitekturë dhe të ruhet ashtu siç është, duke i dhënë rëndësi pjesës artistike dhe arkitektonike të ndërtesës. D.m.th, ajo që është krijuar me qëllime politike në të kaluarën, sot mund të shihet si diçka kryesisht estetike dhe artistike.

Kujtesa në rastin e Piramidës na vjen e ndryshme. Për disa është një monument që të kujton kohët e errëta të komunizmit, vuajtjet dhe varfërinë. Për të tjerë, të rinj, një disko ku edhe gjatë ditës mund të shpenzoje disa orë argëtimi. Ndërsa, për një pjesë tjetër, një rrëmujë e madhe debati se çfarë do të bëhet me të: Do të jetë një qendër e famshme kulturore, një teatër, një muze kombëtar, bibliotekë apo një parlament modern? Megjithatë, janë mjaft të rëndësishme të shihen dhe dallimet e brezave. Për brezin më të vjetër, Piramida lidhet me diktatorin apo ngjarjet kulturore të asaj periudhe, ndërsa për brezin e ri Piramida lidhet me qytetin dhe me ngjarjet kulturore të organizuara pas periudhës komuniste, pasi tek ky brez roli origjinal i këtij monumenti ka humbur.²⁷

Pas kësaj, Partia Socialiste (e sapo ardhur në pushtet) ka hedhur poshtë planet e shkatërrimit duke e ripërdorur përsëri ndërtesën për aktivitete kulturore, si koncerte, panairë dhe ekspozita arti. Megjithatë, Piramida vazhdon të jetë pjesë e debateve për ri-funksionalizimin e saj. Së fundmi, kryetari i bashkisë Erjon Veliaj deklaroi se do të ndryshojë terësisht ndërtesën aktuale, duke e vënë atë në shërbim të inovacionit, teknologjisë, artit dhe kulturës.²⁸ Në këtë moment, çështja kryesore është gjendja e ndërtesës, pasi përpjekjet e vazhdueshme për të ndryshuar funksionin e saj, e kanë lënë atë pa asnjë

²⁷ Këto evidenca vijnë nga vrojtimi i autores gjatë intervistave për prishjen e Piramidës dhe kthimin e saj në parlament. Debat i zhvilluar në Tiranë gjatë vitit 2010.

²⁸ Në debatet për rifunksionalizimin e saj me dt. 2 shkurt 2018, Kryetari i Bashkisë së Tiranës, z **Erion Veliaj** në ICT Awards, deklaroi se bashkia ka marrë vendimin për të kthyer Piramidën e Tiranës në qendrën më të madhe të IT-së në rajon. Konsultuar për herë të fundit më 17 tetor 2018, <http://infosot.com/erion-veliaj-ne-ict-awards-piramida-e-tiranes-do-te-behet-qendra-me-e-madhe-e-it-ne-rajon/>.

mirëmbajtje dhe në një stad degradimi. Kjo është edhe një ndër faktorët kryesor që u shfaq si shqetësim edhe tek turistët e intervistuar nga autori.




Fig. 3. Gjendja e Piramidës gjatë diskutimeve për ri-funksionalizimin e saj²⁹

Pse vizitohet Piramida nga turistët?

Ndërkohë që debatet për funksionin e këtij monumenti vazhdojnë, Piramida është një ndër destinacionet kryesore në kryeqytet dhe, siç e parashtruam, ajo është futur dhe në kategorinë e turizmit të errët. Janë realizuar 12 intervista në agjencitë turistike në kryeqytet me disa turistë të rastit, rreth informacionit që ata kanë për këtë lloj turizmi. Këto intervista u realizuan në ambientet e agjencive turistike në Tiranë. Është për t'u theksuar fakti që të gjithë të intervistuarit vinin nga vendet lindore. Pyetjet kryesore që u diskutuan gjatë intervistave ishin: "Cilat janë arsyet kryesore që vizitohen monumentet e periudhës komuniste, dhe më konkretisht Piramida? Pse ata janë të interesuar t'i shohin këto monumente?"

Pas analizës së plotë të intervistave të kryera, ato u grupuan në ndarje të veçanta për të kuptuar më mirë arsyet e vizitave të tyre. Nga këto nxjerrim rezultatet e mëposhtme:

-Reagimet emocionale:

Shumë nga turistët shfaqën reagime emocionale, për sa i përket gjendjes së monumentit dhe trajtimit të periudhës së komunizmit në Shqipëri. Ata shprehen:

²⁹ Foto tërhequr nga <https://albanianpyramids.wordpress.com/2012/01/21/enver-hoxhas-pyramid>, 15 gusht 2018.

“Ju mund të ngjiteni në majë të Piramidës edhe pse nuk është e ligjshme ta bëni këtë - askush nuk do t’ju ndalojë, e bëjnë shpesh. Ajo është e mbuluar me grafitë dhe nuk mund të hyni brenda. I trishtuar sepse duket interesante”³⁰

Disa të tjerë e shohim monumentin si simbol i regjimit të vjetër:

“Është një nga monumentet e regjimit komunist dhe të jep një ide për ndjenjën e popullit kundër regjimit. Ajo është shkatërruar dhe është e mbuluar me grafitë duke pritur për t’u prishur ose për t’u ripërdorur. Megjithatë ky monument i lënë në harresë është diçka që turistët duhet të shohin pasi historia e saj është mjaft interesante. Do të më pëlqente që të ripërdorej për muze apo qëllime arsimore”³¹

Një tjetër vizitor shprehet:

“Është mjaft interesante të shohësh se si shqiptarët merren me të kaluarën dhe me diktatorin Enver Hoxha. Në këtë rast, muzeu që u krijua për nder të tij është shkatërruar. Vëndi është i mbuluar me mbishkrime, dhe njerëz që rrinë lart dhe rrëshqasin në sipërfaqet e tyre. Që të dyja janë metaforë e mprehtë me mënyrën se si njerëzit mund t’i përgjigjen trashëgimisë së saj”³²

Përkundër perspektivës së ndryshme që turistët mund të kenë mbi monumentin, ai arrin të ketë një ndikim emocional, veçanërisht keqardhje dhe trishtim për gjendjen e tij. Në mbështetje të intervistave, Sharpley dhe Stone theksojnë se "vendet e errëta dhe atraksionet ka të ngjarë të japin, në shkallë të ndryshme, një reagim emocional tek vizitorët" (Sharpley and Stone 2009, 111).

-Domosdoshmëri

Pjesa më e madhe e të intervistuarve deklaruan se arsyeja kryesore për vizitën e këtyre monumenteve ishte fakti se ato e shohin si një “domosdoshmëri” kur vizitojnë një vend. p.sh., gjithmonë vizitohej Piramida në Tiranë si “duhet parë” kur shihej kryeqyteti. Pra, shohim një lidhje mes vizitës së një vendi të panjohur dhe dëshirës për të mësuar rreth historisë së tij.

³⁰ R.R., vizitor, 39 vjeç. Intervistë e realizuar në nëntor 2017.

³¹ H. S., vizitor, 36 vjeç. Intervistë e realizuar në nëntor 2017

³² R. S., vizitor nga Gjermania, 43 vjeç. Intervistë e realizuar në nëntor 2017

Një turist nga Gjermania shprehet: "Nëse jeni në Tiranë, është e domosdoshme të vizitosh Piramidën"³³ Këtu mund të argumentohet se kjo vlen për të gjitha atraksionet turistike në gjithë botën pa marrë parasysh natyrën e tyre. Kur vizitojmë Budapestin, e shohim si "domodoshmëri" për të vizituar "House of Terror" apo kur vizitojmë Berlinin "DDR Museum" etj.

-Vendndodhja e monumentit

Një çështje tjetër mjaft e rëndësishme që vizitorët përmendën gjatë intervistës, ishte vendndodhja e monumentit. Ato e shohin vendndodhjen e Piramidës si mjaft të përshtatshme dhe lehtësisht të arritshme: "i vendosur në mes të kryeqytetit, nuk mund të mos të të tërheqë vëmendjen"³⁴. "Është në qendër të qytetit, kështu që një vizitë do të jetë rrugës kur të shohë vendet e tjera të Tiranës."³⁵

-Historia e periudhës së diktaturës komuniste

Dëshira për të njohur historinë e Shqipërisë është një ndër përgjigjet më normale gjatë intervistave dhe turistët tregojnë se për të njohur historinë e Shqipërisë gjatë periudhës komuniste, ata janë të interesuar të vizitojnë muzetë e fundit, si: Muzeu i Gjethit apo Bunk'art, përveç Muzeut Historik Kombëtar. Ata e vlerësojnë mjaft ekzistencën e këtyre vendeve. Këtë e konfirmuan edhe ciceronët apo guidat lokale, kur treguan se turistët ishin të interesuar për temën e komunizmit dhe kërkonin të fitonin njohuri të mëtejshme dhe të merrnin informacione shtesë duke parë edhe këto vende.

F. M, guidë lokale shton: "Për të mësuar më shumë për historinë e Shqipërisë ne i çojmë turistët të vizitojnë këto muze apo vende që lidhen me periudhën e komunizmit, aty turistët mund të kuptojnë më mirë se çfarë ka ndodhur".³⁶ Ai thekson se këto vende janë shumë të rëndësishme për të përkujtuar të shkuarën si dhe për turizmin: "nuk duhet harruar e kaluara [...] prandaj është shumë e rëndësishme që këto vende të ekzistojnë".³⁷

-Arkitektura

³³ R. S., vizitor, 43 vjeç. Intervistë e realizuar në nëntor 2017

³⁴ R.R., vizitor, 39 vjeç. Intervistë e realizuar në nëntor 2017

³⁵ H.S., vizitor, 36 vjeç. Intervistë e realizuar në nëntor 2017

³⁶ F.M., guide 34 vjeç. Intervistë e realizuar në nëntor 2017

³⁷ F.M., guide 34 vjeç. Intervistë e realizuar në nëntor 2017

Sipas turistëve, një arsye tjetër pse duhet vizituar Piramida është dhe arkitektura e ndërtimit të saj, duke e konsideruar atë si një “një nga simbolet e Tiranës” apo “arkitekturë unike”.³⁸

-Ndjeshmëria

Gjithashtu kureshtja dhe ndjeshmëria janë disa nga arsyet kryesore për disa të tjerë.

Një turist i ndodhur në ambientet e agjencisë turistike shprehet: "mendoj se isha kurioz për të parë monumentet e kësaj periudhe dhe të dija më shumë se si njerëzit kanë jetuar në ato kohë."³⁹

Gjetje të ngjashme janë bërë në lidhje me ndjeshmërinë. Sipas turistëve, meqenëse historia e vendit është kaq unike dhe e pakompromentuar ende, ata ndihen sikur të ishte e padrejtë nëse nuk do t'i vizitonin këto vende gjatë vizitës në Shqipëri. Sipas Ashworth dhe Hartmann ndjeshmëria dhe kurioziteti, janë nxitësit kryesorë për turizmin e errët (2005). Turisti E. S. shprehet: "Unë mendoj se në qoftë se nuk do të kisha vizituar këto vende që kanë lidhje me historinë e komunizmit në Shqipëri, do të më dukej sikur nuk do të respektoja atë që njerëzit kaluan, gjë që nuk më duket e drejtë."⁴⁰ Nëpërmjet këtij komenti shihet lidhja me argumentin e ndjeshmërisë, duke qëndruar si dëshmi se ndjeshmëria luan një rol të rëndësishëm në motivimet turistike me qëllimin kryesor të konsumimit të turizmit të errët.

-Autenticiteti

Guidat vendase treguan se me siguri të gjithë turistët do t'i rekomandojnë këto muze dhe monumente tek miqtë dhe familjet që mendojnë të vizitojnë Shqipërinë. Ato treguan se disa turistë i kishin vizituar edhe për herë të dytë duke i perceptuar ato si mjaft autentike. Gjithashtu, ata shtuan se asnjë nga pjesëmarrësit nuk udhëton në Shqipëri vetëm për shkak të historisë së saj apo për të vizituar këto vende. Ata deklaruan se turistët në shumë raste nuk e kishin planifikuar paraprakisht vizitat në këto vende, por ata ose planifikonin vizitën vetëm pasi kishin mbërritur ose agjencitë i kishin paraqitur guidën në këto vende. Pra, autenticiteti është një faktor i rëndësishëm në motivimin e turistëve

³⁸ H.M., vizitor 47 vjeç. Intervistë e realizuar në nëntor 2017

³⁹ M.F., vizitor 63 vjeç. Intervistë e realizuar në nëntor 2017

⁴⁰ E.S., vizitor, 29 vjeç. Intervistë e realizuar në nëntor 2017.

për të parë këto vende dhe ka gjithashtu aftësinë për të krijuar dhe përforcuar emocionet turistike, të cilat mund të çojnë në përvojat turistike kuptimplota. Këto emocione mund të gjenerojnë dëshirën turistike për të vizituar edhe atraksionet e tjera të errëta ose për t'i rekomanduar këto vende edhe tek të tjerët.

Të gjitha sa diskutuam më lart ishin problemet rreth monumenteve apo muzeve që lidhen me trashëgiminë e periudhës komuniste në Shqipëri, por asnjë nga të intervistuarit nuk ishte i njohur me termin “turizëm i errët”. Prandaj, turistët nuk angazhohen në një aspekt të tillë të turizmit me vetëdije dhe i perceptojnë monumentet, muzetë e kësaj periudhe si atraksione të rregullta turistike. Sipas analizës së intervistave të kryera, turistët zgjedhin të vizitojnë këto vende për të fituar njohuri të mëtejshme duke theksuar faktorin edukativ dhe informativ të nënkuptuar në vizitën e monumenteve apo muzeve si një nga përgjigjet e para në pyetjen se pse ata i vizitojnë këto vende. Sipas këtij studimi, dëshira për të fituar më shumë informacion duket të jetë arsyeja kryesore e vizitave të atraksioneve të errëta. Argëtimi nuk është qëllimi i vetëm i udhëtimeve të kohës së lirë, pasi të gjithë intervistuesit deklaruan se nuk mund të imagjinonin të largoheshin nga vendi, pa u angazhuar në asnjë aspekt kulturor të tij.

Përfundime

Ngjashëm me turizmin kulturor, turizmi i errët është një lloj i diskutueshëm dhe ideologjikisht i mbingarkuar i turizmit me interes të veçantë. Hapësira që zë ky turizëm është i gjerë: që nga ekspozitat e thjeshta e deri tek kampet e gjenocidit, por ka hapësirë për zgjerimin e këtij turizmi edhe me trashëgiminë komuniste, i cili mund të krijojë nënndarjet e veta. Për shkak të shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe vendeve, ka ende shumë që nuk dihet për këtë formë të turizmit. Problemi që lind kur analizojmë destinacionet kryesore të këtij turizmi, është se nuk ka indikacione të qarta nga agjencitë turistike për këtë turizëm dhe gjithashtu, nuk ka statistika për numrin e turistëve që vizitojnë këtë trashëgimi.

Në këtë punim jam përpjekur të ndërtoj një kornizë konceptuale të turizmit të errët dhe duke u bazuar në këto të shihet nëse Shqipëria ka burime për zhvillimin e këtij turizmi. Na rezultoi që Piramida duke u bazuar në tipologjitë e vendeve të errëta, sipas Stone-it (2005, 153-156), mund të bëjë pjesë në

turizmin e errët, megjithëse përgjatë viteve mund të ketë kaluar përmes spektrave të errët, duke qënë se ka ndryshuar disa herë funksionin e saj.

Nga intervistat rezultoi se turistët në shumë raste nuk i kishin planifikuar paraprakisht vizitat në këto vende, por ato ose planifikonin vizitën vetëm pasi kishin mbërritur ose pasi agjencitë i kishin paraqitur guidën në këto vende. Pra, mund të themi se turistët nuk angazhohen në mënyrë të ndërgjegjshme në turizmin e errët. Arsyet pse turisti viziton këto vende mund të jenë të ndryshme sipas kohës dhe çdo individ, si pasojë ai mund të përjetojë të gjitha llojet e emocioneve duke filluar nga kurioziteti i tij për të panjohurën, historia, arkitektura, autenticiteti si dhe hapësira që zënë ato dhe duke përfunduar me emocione të tilla, si: keqardhje, zemërim, kuriozitet etj. Për më tepër, duhet theksuar se secili individ ndryshon në bazë të nivelit të tij të dijes dhe të kuptuarit e për këtë arsye, mund të përjetojë emocione të caktuara në mënyra të ndryshme nga vizitorët e tjerë. Me fjalë të tjera, në qoftë se për disa turistë përvoja mund të vijë si identifikim personal me vendin e trashëgimisë ose thjesht si një mënyrë për të kënaqur një kuriozitet, për disa të tjerë, mund të përfaqësojë vetëm një tërheqje se "duhet parë". Gjithsesi, ky është rezultat paraprak i këtij punimi dhe nuk mund të përgjithësohet në qëndrim të plotë rreth këtij problemi.

Pa harruar të gjitha aspektet e mundshme të kësaj teme, ky punim është një përpjekje e parë për të paraqitur çështjet komplekse që lidhen me qasjet dhe veprimet lidhur me trashëgiminë komuniste në Shqipëri dhe në veçanti me turizmin e errët.

Bibliografi

- Adhami, Stilian. 2001. *Muzeologjia shqiptare*. Tiranë: Gervis
- Ashworth, Gregory dhe Rudi Hartmann. 2005. "Introduction: Managing Atrocity for Tourism". Në *Horror and Human Tragedy Revisited. The Management of Sites of Atrocities for Tourism* përgatitur nga Gregory Ashworth dhe Rudi Hartmann, 11-14. New York: Cognizant Communication Cooperation
- Ashworth, Gregory dhe John Tunbridge. 2000. *The Tourist-historic City: Retrospect and Prospect of Managing the Heritage City*. Oxford: Pergamon.

- Foley, Malcolm dhe Lennon John. 1996. "JFK and dark tourism: A fascination with assassination" *International Journal of Heritage Studies* 2 (4), 198-211.
- Graham, Brian, Ashworth, Gregory. dhe John Tunbridge. 2000. *A geography of heritage. Power, Culture and Economy*. London: Arnold
- Klosi, Ardian dhe Artan Lame, përg. 2011. *Piramida e Tiranës: e bijshme, e braktisur, e rrezikuar*, Tiranë: Dudaj
- Lennon, John dhe Malcolm Foley. 1996. "JFK and dark tourism: a fascination with assassination". *International Journal of Heritage Studies* 2: 198-211
- Lennon, John dhe Malcolm Foley. 2000. *Dark tourism: the attraction of death and disaster*. Cengage Learning EMEA
- Lennon, John dhe Malcolm Foley. 2002. *Dark tourism: the attraction of death and disaster*. London, England: Continuum
- Light, Duncan. 2000. "An unwanted past: contemporary tourism and the heritage of communism in Romania". *International Journal of Heritage Studies*, vol 6 (2): 145-160
- Light, Duncan. 2000. "Gazing on communism: heritage tourism and post-communist identities in Germany, Hungary and Romania" *Tourism Geographies* 2: 157-176
- MacCannell, Dean. 1999. *The Tourist: A New Theory of the Leisure Class* Berkeley: University of California Press.
- Macdonald, Sharon. 2006. "Undesirable Heritage: Fascist Material Culture and Historical Consciousness in Nuremberg". *International Journal of Heritage Studies*, 12(1): 9-28
- Macdonald, Sharon. 2009. *Difficult heritage: negotiating the nazi past in Nuremberg and Beyond*. New York: Routledge.
- Schouten, Frans. 2005. "The process of authenticating souvenirs" Në *Cultural Tourism in a changing world: Politics, Participation and (re)presentation*, përgatitur nga Melanie K. Smith dhe Mike Robinson, 191-202. Clevedon: Channel View Publications.
- Seaton, A.V. 1999. "War and thanatourism: Waterloo 1815 -1914". *Annals of Tourism Research*, 26 (1): 130-158.
- Stone Philip. R. 2005. "Consuming dark tourism: a call for research." *Review of Tourism Research*, Vol. 3 (5): 109-117.
- Stone Philip. R. 2005. "Dark Tourism-an old concept in a new world". *Tourism*, The Tourism Society, Quarter IV (25): 20.

- Stone Philip. R. 2011. "Dark tourism: towards a new post-disciplinary research agenda," *Int. J. Tourism Anthropology*, Vol. 1, (3/4): 318-332.
- Stone, Philip dhe Richard Sharpley. 2008. "Consuming Dark Tourism: a Thanatological Perspective". *Annals of Tourism Research* 35(2): 574–595.
- Stone, Philip. R. 2006. "A dark tourism spectrum: towards a typology of death and macabre related tourist sites, attractions and exhibitions." *Tourism: An Interdisciplinary International Journal*, 54 (2): 145–160.
- Sharpley, Richard dhe Philip. R Stone. 2009. "(Re)presenting the macabre: interpretation, kitschification and authenticity." Në *The Darker Side of Travel: The Theory and Practice of Dark Tourism*, përgatitur nga Richard Sharpley dhe Philip R.Stone,109-128. Bristol: Channel View Publications.
- Sharpley, Richard. 2005. "Travels to the Edge of Darkness: Towards a Typology of Dark Tourism." Në *Taking Tourism to the Limits: Issues, Concepts and Managerial Perspectives*, përgatitur nga Chris Ryan, Stephen Page dhe Michelle Aicken, 217- 228. Oxford: Elsevier.
- Verdery, Katherine. 1999. *The Political Lives of Dead Bodies:Reburial and Postsocialist Change*. New York: Columbia University Press.
- Walter, Tony. 2009. "Dark tourism: mediating between the dead and the living". Në *The Darker Side of Travel– The Theory and Practice of Dark Tourism*, përgatitur nga Richard Sharpley dhe Philip Stone, 39-55. Bristol: Channel View Publications.